



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE  
MIRËQENIES SOCIALE

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 3926 prot.,  
Tiranë më, 29.04.2026

MINISTRIA E PUNËVE TË  
BRENDSHME

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË  
PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE  
TË KONFISKUARA

Nr. 2168 prot.  
Tiranë më, 29.04.2026

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET

AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË  
KONFISKUARA

DHE

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Në mbështetje të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar, ligjit nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", i ndryshuar, ligjit nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", ligjit nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", i ndryshuar, ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", VKM-së nr. 135/2018, "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror" i ndryshuar, VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020 "Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara", Udhëzimit nr. 324, datë 2.10.2020 "Për përcaktimin e rregullave, procedurave për administrimin e të ardhurave dhe limiteve të kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara" dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse,

Sot më datë \_\_\_/02/ 2026 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

**Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, AAPSK**, me Nipt K82102451K, me seli Rruga e Kavajës, “Kompleksi Delijorgji”, Kulla C1, Kati 1, H2, Tiranë, përfaqësuar nga **znj. Risena Xhaja**, në cilësinë e Kryeadministratorit,

**dhe**

**Shërbimi Social Shtetëror** (referuar si SHSSH), me adresë: Rruga e Durrësit, nr.83, Tiranë, Kodi Postar 1001, i përfaqësuar nga *Drejtor i Përgjithshëm*, **Zj. Reme Xholi**, si më poshtë vijon:

### **Neni 1 Objekti**

Objekt i kësaj marrëveshje është vënien në dispozicion dhe përdorimi i mjeteve/pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara, të administruara nga AAPSK, për nevoja funksionale të institucioneve që funksionojnë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, nëpërmjet lidhjes së kontratave të qirasë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 2 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi ndërinstitucional për krijimin e një mekanizmi bashkëpunimi ndërinstitucional për evidentimin, e më pas vijimin e procedurave të qirasë, me qëllim përdorimin e mjeteve/pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara, të administruara nga AAPSK, për nevoja funksionale të institucioneve që funksionojnë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror.

### **Neni 3**

**Detyrimet e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara**

**AAPSK ka për detyrë:**

1. Të shqyrtojë kërkesat për dhënie me qira të mjeteve;
2. Të hartojë dhe lidhë kontrata qiraje me institucionet e varësisë së SHSSH-së, sipas kushteve të përcaktuara ligjore;
3. Të administrojë të ardhurat nga qiraja në përputhje me Ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”;

### **Neni 4**

## Detyrimet e Shërbimi Social Shtetëror

### SHSSH, ka për detyrë:

1. Të verifikojë nevojat e institucioneve të varësisë për mjete dhe koordinon procesin e kërkesave për marrje me qira;
2. Të japë dakordësinë institucionale për lidhjen e kontratave të qirasë;
3. Të mbikëqyrë që mjetet e marra me qira të përdoren vetëm për nevoja funksionale të institucioneve.

### Neni 5 Afati i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një periudhë 2 (dy) vjeçare, me të drejtë rinovimi dhe shërben si bazë për kontratat e qirasë që lidhen gjatë këtij afati. Çdo palë mund të kërkojë përfundimin e marrëveshjes duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 30 ditë përpara.

### Neni 6 Mbrotja e të dhënave personale

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi angazhohen të respektojnë të gjitha dispozitat e ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

### Neni 7 Personat e Kontaktit

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin në mënyrë verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:
2. Për SHSSH: Z/Znj. Reme Xholi, e-mail: [Reme.Xholi@sherbimisocial.gov.al](mailto:Reme.Xholi@sherbimisocial.gov.al)
3. Për AAPSK: Z/Znj. Risena Xhaja, e-mail: [Risena.Xhaja@aapsk.gov.al](mailto:Risena.Xhaja@aapsk.gov.al) ,
4. Personat e caktuar do të jenë përgjegjës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
5. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

## Neni 8 Forca Madhore

1. Mospërmbushja e pjesshme apo e plotë e kësaj marrëveshje për shkak të forcave madhore, nuk ngarkon me përgjegjësi palët.
2. Në çdo rast të forcës madhore, palët kanë detyrimin të njoftojnë për ekzistencën e forcës madhore në kohën më të shpejtë të mundshme, por në çdo rast jo më vonë se 15 ditë nga fillimi i situatës së forcës madhore.

## Neni 9 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

## Neni 10 Dispozita Përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet deri në përfundimit e afatit sipas nenit 5 të marrëveshjes.
2. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse në marrëveshje.
3. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për zgjidhjen e çdo problematike që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.
4. Çdo ndryshim në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi bëhet me konsensus të palëve dhe formalizohet me akt shtesë.
5. Marrëveshja e Bashkëpunimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

PËR  
SHËRBIMIN SOCIAL  
SHTETËROR

DREJTORI PËRGJITHSHËM  
Reme XHOLI



PËR  
AGJENCINË E ADMINISTRIMIT TË  
PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE  
TË KONFISKUARA

KRYEADMINISTRATORI  
Risë XHAJA

